



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
DREJTORIA E TARIFAVE DHE ÇMIMEVE

RELACION  
MBI  
MIRATIMIN E TARIFËS SË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR  
PERIUDHËN 2025-2027

Bordit të ERE-s

Këtu

Të nderuar anëtarë të Bordit,

Në zbatim të nenit 19, gërma c), pika i) të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, Enti Rregullator i Energjisë është autoriteti përgjegjës për miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike.

ERE me vendimin e bordit nr. 180, datë 08.11.2017, ka miratuar “Metodologjinë e llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike”, e cila ka për qëllim përcaktimin e parimeve, kushteve dhe procedurave të tarifave të përdorimit të rrjetit të transmetimit mbi bazën e parimeve të llogaritjes së këtyre tarifave duke vlerësuar të dhënat e domosdoshme për një tarifë të drejtë.

Konform pikës 1, të nenit 21 të “Rregullores për Organizimin, Funkionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016 të bordit të ERE-s, i licencuari që kërkon përcaktimin e tarifave dhe çmimeve të shërbimeve të energjisë elektrike dhe të gazit natyror për vitin pasardhës, jo më vonë se data 1 shtator të vitit aktual, duhet të paraqesë në ERE një kërkesë me shkrim të shoqëruar me të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar sipas kësaj rregullore dhe metodologjive përkatëse.

Aplikimi i paraqitur duhet të përmbushë kërkesat e nenit 22, të “Rregullores për Organizimin, Funkionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016 të bordit të ERE-s si dhe të “Sistemit të njëjsuar dhe të standardizuar të llogarive për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike për aktivitetin e transmetimit, shpërndarjes dhe furnizuesit të shërbimit universal të energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin bordit të ERE-s nr. 244, datë 26.11.2018.

Shoqëria OST sh.a me shkresën nr. 6004 prot., datë 23.08.2024 (protokolluar me tonën me nr. 1859 prot., datë 03.09.2024), ka depozituar në ERE “Kërkesën për Aplikim për Tarifën e Transmetimit të Energjisë Elektrike për periudhën 2025-2027”. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria OST sh.a., dhe pasi vlerësoi se aplikimi përmbushte të gjithë kushtet e dispozitave ligjore të sipërcituara, me relacionin nr. 1859/1 prot.,

datë 13.09.2024, i propozoi bordit të ERE-s fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë OST sh.a.

Sa më sipër, bordi i ERE-s me vendimin nr. 192, datë 18.09.2024, vendosi: **“Fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë OST sh.a për përcaktimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 2025 - 2027”**.

Në vijim të vendimit të mësipërm, në zbatim të dispozitavetë Ligjit nr. 43/2015 *“Për sektorin e energjisë”*, i ndryshuar, *“Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, si dhe *“Metodologjinë e llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike”* miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 180, datë 08.11.2017, u zhvilluan hapat procedural si më poshtë:

1. ERE me shkresën nr. 1859/2 prot., datë 20.09.2024, me qëllim ruajtjen e parimeve të transparencës si dhe të një vendimmarrje sa më të drejtë dhe kostro-reflektuese, i kërkoi shoqërisë OST sh.a dhënien e argumenteve, informacioneve dhe dokumentacionit shtesë në lidhje me çështjet e evidentuara nga shqyrtimi i materialeve të përcjella në kuadër të aplikimit për tarifën e transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 2025 - 2027.
2. Më tej, me shkresën nr. 1859/3 prot., datë 20.09.2024, ERE njoftoi palët e interesit mbi *“Fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të OST sh.a për tarifën e Transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 2025 - 2027”*.
3. OST sh.a. me shkresën nr. 6004/2 prot., datë 07.10.2024, protokolluar me tonën me nr. 1859/4 prot., datë 09.10.2024, përcolloi në ERE sqarime, argumenta si dhe evidenca në përgjigje të kërkesës së ERE nr. 1859/2 prot., të datës 20.09.2024 (të cituar më lart).
4. Në vijim, në zbatim të Urdhrit të Kryetarit të ERE-s nr. 142, datë 28.10.2024, u zhvillua seanca teknike ndërmjet përfaqësuesve të ERE-s dhe të shoqërisë OST sh.a. ku u diskutua në lidhje me informacionin, argumentet dhe dokumentacionin e paraqitur nga shoqëria në aplikim dhe në shkresën respektive.
5. Me anë të e-mailit të datës 04.11.2024, dërguar nga adresa zyrtare e ERE [erealb@ere.gov.al](mailto:erealb@ere.gov.al), ju kërkua OST sh.a. vënia në dijeni, nëpërmjet postës elektronike nëse shoqëria kish përmbushur detyrimin për publikimin e masës së propozuar për ndryshimin e tarifave, duke e shprehur ndryshimin e kërkuar gjithashtu në përqindjen për çdo klasë/grup konsumatorësh, si dhe duke pasqyruar qartë emërtimin e tyre. Ky publikim duhej të kryhej në jo më pak se dy/tre gazeta me qarkullim në nivel vendi, apo në zonën ku aplikuesi siguron shërbimin sikurse përcaktuar në nenin 22, pika 6 të *“Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”*.
6. Bazuar në nenin 22, pika 6, të *“Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”*, me anë të shkresave me nr. 1859/8 prot., nr.1859/9, prot., nr. 1859/10 prot., të datës 08.11.2024, u dërgua njoftimi për shtypin e shkruar në tre gazeta me qarkullim kombëtar, me anë të të cilit u bë me dije për publikun masa e propozuar

nga OST sh.a për ndryshimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 2025 - 2027.

7. Më tej, duke marrë shkas nga pyetjet e trajtuara gjatë seancës teknike, me qëllim ezaurimin e çdo paqartësie të evidentuar, ERE me shkresën me nr. 1859/12, prot., datë 20.11.2024 ju drejtua sërish shoqërisë OST sh.a për dhënien e informacioneve, argumenteve si dhe dokumentacioneve mbështetëse të nevojshme për procesin e vendimmarrjes.
8. Në zbatim të Udhrit të Kryetarit të ERE-s nr. 160, datë 20.11.2024, me shkresat nr. 1859/15 prot., nr. 1859/16 prot., dhe nr. 1859/17 prot., të datës 20.11.2024, u njoftuan të gjithë palët e interesit mbi zhvillimin e seancës zyrtare publike.
9. OST sh.a. me shkresën nr. 6004/7 prot., datë 02.12.2024, protokolluar me tonën me nr. 1859/19 prot., datë 03.12.2024, përcolli argumentet si dhe sqarimet e saj në lidhje me pyetjet e drejtuara nga ERE me shkresën nr. 1859/12, prot., datë 20.11.2024.
10. ERE në datë 06.12.2024 organizoi seancën zyrtare publike, ku palët e interesit parashtruan pyetjet e tyre në lidhje me aplikimin e shoqërisë OST sh.a. për përcaktimin e tarifës së transmetimit për periudhën 2025 - 2027. Theksojmë se: pyetjet e drejtuara nga palët e interesit që u përfaqësuan në këtë seancë patën karakter të përgjithshëm.

Sa më sipër, bëjmë me dije se Aplikimi i tarifës për periudhëm 2025 - 2027, materialet plotësuese të përcjella nga shoqëria OST sh.a. si dhe komentet e kryera nga palët e interesit në lidhje me propozimin e Operatorit janë publikuar në faqen elektronike të ERE-s [www.ere.gov.al](http://www.ere.gov.al) sipas afateve të përcaktuara në “*Rregulloren për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*”.

**Referuar të dhënave të Aplikimit, të përcjella nga OST sh.a. me shkresën nr. 6004 prot., datë 23.08.2024 (protokolluar me tonën me nr. 1859 prot., datë 03.09.2024), të ardhurat e kërkuara të realizuara për vitin 2023 dhe parashikimi për mbylljen e vitit 2024 si dhe për periudhën 2025 - 2027, paraqiten në tabelat si më poshtë:**

Tabela 1: Të ardhurat e realizuara për 2023 dhe parashikimi për mbylljen e vitit 2024 sipas OST sh.a.

Emertimi	Njesia matese	OST Aktuale		OST Rishikim	
		2023	2024	2023	2024
<b>Energjia Totale që hyn në sistemin e OST</b>	<b>GWh</b>	<b>10,147</b>	<b>10,296</b>	<b>10,147</b>	<b>10,296</b>
<i>Prodhim vendas</i>	"	8,226	7,707	8,226	7,707
<i>Energji në marrje</i>	"	1,922	2,589	1,922	2,589
<b>Energjia totale e transmetuar</b>	<b>GWh</b>	<b>9,927</b>	<b>10,081</b>	<b>9,927</b>	<b>10,081</b>
<i>Energji elektrike e dhënë</i>	"	2,842	2,658	2,842	2,658
<i>Energji elektrike për OSHEE sh.a.</i>	"	6,492	6,788	6,492	6,788
<i>Energji elektrike për konsumatorët e kualifikuar</i>	"	594	635	594	635
<b>Humbjet në GWh</b>	<b>GWh</b>	<b>220</b>	<b>214</b>	<b>220</b>	<b>214</b>
<b>Humbjet në %</b>	<b>%</b>	<b>2.17%</b>	<b>2.08%</b>	<b>2.17%</b>	<b>2.08%</b>
<b>Konsumi</b>	<b>GWh</b>	<b>7,086</b>	<b>7,423</b>	<b>7,086</b>	<b>7,423</b>
<b>Çmimi i blerjes së Energjisë humbjet</b>	<b>EUR/MWh</b>	<b>88.46</b>	<b>90.56</b>	<b>88.46</b>	<b>90.56</b>
Vlera e humbjeve	EUR	19,483,739	19,395,620	19,483,739	19,395,620
Vlera e humbjeve	Mln leke	2,124	1,940	2,124	1,940
<b>C Operuese</b>	<b>Mln leke</b>	<b>5,698</b>	<b>5,756</b>	<b>5,698</b>	<b>5,756</b>
<b>Energjia</b>	<b>Mln leke</b>	<b>3,308</b>	<b>3,355</b>	<b>3,308</b>	<b>3,355</b>
- Humbjet	"	2,124	1,940	2,124	1,940
- Sherbimet Ndihmese	"	806	1,101	806	1,101
- Menaxhimi i kongjestionit me ridispecim	"	0	0	0	0
- ITC	"	378	314	378	314
<b>Kosto shfrytëzimit</b>	<b>Mln leke</b>	<b>2,390</b>	<b>2,402</b>	<b>2,390</b>	<b>2,402</b>
- Personeli	"	1,201	1,519	1,201	1,519
- Materiale	"	103	119	103	119
- Furnitura & Sherbime	"	1,086	764	1,086	764
<b>Investimet e vitit</b>	<b>Mln leke</b>	<b>3,435</b>	<b>7,664</b>	<b>3,435</b>	<b>7,664</b>
<b>D - Amortizimi</b>	<b>Mln leke</b>	<b>2,563</b>	<b>2,534</b>	<b>2,563</b>	<b>2,534</b>
<b>B - Baza e rregulluar e asetëve</b>	<b>Mln leke</b>	<b>33,900</b>	<b>39,031</b>	<b>33,900</b>	<b>39,031</b>
<b>WACC (sipas Vendimit të ERE për tarifen 2022-2024)</b>	<b>%</b>	<b>5.15%</b>	<b>2.55%</b>	<b>2.28%</b>	<b>2.28%</b>
<b>R - Kthimi mbi kapitalin (R = B*WACC)</b>	<b>Mln leke</b>	<b>1,746</b>	<b>997</b>	<b>773</b>	<b>890</b>
<b>C kapital= R+D</b>	<b>Mln leke</b>	<b>4,309</b>	<b>3,531</b>	<b>3,336</b>	<b>3,424</b>
<b>C - Ardhurat kerkuara (C operuese + C kapital)</b>	<b>Mln leke</b>	<b>10,007</b>	<b>9,287</b>	<b>9,034</b>	<b>9,180</b>
<b>Te ardhurat nga aktivitetet tjera</b>	<b>Mln leke</b>	<b>3,957</b>	<b>2,977</b>	<b>3,957</b>	<b>2,977</b>
Ardhura tjera që zbriten nga te ardhurat e kerkuara	"	3,957	2,977	3,957	2,977
Rregullime për periudhat e meparshme rregullatore	"				
<b>Ardhurat kerkuara neto</b>	<b>Mln leke</b>	<b>6,050</b>	<b>6,310</b>	<b>5,077</b>	<b>6,203</b>
<b>Tarifa mesatare e transmetimit</b>	<b>leke/kWh</b>	<b>0.85</b>	<b>0.85</b>	<b>0.72</b>	<b>0.84</b>

Burimi: OST sh.a.

Tabela 2: Të ardhurat e kërkuara për periudhën 2025 - 2027 sipas OST sh.a

		OST PLAN 2025-2027 (ME KONGJESTION)			
Emertimi	Njesia matese	2025	2026	2027	2025-2027
<b>Energjia Totale që hyn në sistemin e OST</b>	<b>GWh</b>	<b>10,553</b>	<b>10,684</b>	<b>10,833</b>	<b>32,069</b>
<i>Prodhim vendas</i>	"	8,136	8,388	8,539	25,063
<i>Energji në marrje</i>	"	2,417	2,296	2,294	7,007
<b>Energjia totale e transmetuar</b>	<b>GWh</b>	<b>10,325</b>	<b>10,450</b>	<b>10,585</b>	<b>31,360</b>
<i>Energji elektrike e dhënë</i>	"	2,924	3,070	3,224	9,218
<i>Energji elektrike për OSHEE sh.a.</i>	"	6,734	6,680	6,627	20,041
<i>Energji elektrike për konsumatorët e kualifikuar</i>	"	666	700	735	2,101
<b>Humbjet në GWh</b>	<b>GWh</b>	<b>228</b>	<b>234</b>	<b>247</b>	<b>709</b>
<b>Humbjet në %</b>	<b>%</b>	<b>2.16%</b>	<b>2.19%</b>	<b>2.28%</b>	<b>2.21%</b>
<b>Konsumi</b>	<b>GWh</b>	<b>7,401</b>	<b>7,380</b>	<b>7,362</b>	<b>22,142</b>
<b>Çmimi i blerjes së Energjisë humbjet</b>	<b>EUR/MWh</b>	<b>111.80</b>	<b>101.28</b>	<b>89.87</b>	<b>100.68</b>
Vlera e humbjeve	EUR	25,490,400	23,664,970	22,223,292	71,378,663
Vlera e humbjeve	Mln leke	2,549	2,366	2,222	7,138
<b>C Operuese</b>	<b>Mln leke</b>	<b>7,939</b>	<b>8,074</b>	<b>8,493</b>	<b>24,506</b>
<b>Energjia</b>	<b>Mln leke</b>	<b>5,263</b>	<b>5,333</b>	<b>5,685</b>	<b>16,280</b>
- <i>Humbjet</i>	"	2,549	2,366	2,222	7,138
- <i>Sherbimet Ndhimese</i>	"	1,759	1,947	2,377	6,084
- <i>Menaxhimi i kongjestionit me ridispecim</i>	"	654	719	785	2,158
- <i>ITC</i>	"	300	300	300	900
<b>Kosto shfrytëzimit</b>	<b>Mln leke</b>	<b>2,676</b>	<b>2,741</b>	<b>2,808</b>	<b>8,225</b>
- <i>Personeli</i>	"	1,690	1,736	1,784	5,210
- <i>Materiale</i>	"	167	169	171	507
- <i>Furnitura &amp; Sherbime</i>	"	820	836	853	2,509
<b>Investimet e vitit</b>	<b>Mln leke</b>	<b>8,629</b>	<b>3,887</b>	<b>3,513</b>	<b>16,029</b>
<b>D - Amortizimi</b>	<b>Mln leke</b>	<b>2,610</b>	<b>2,688</b>	<b>2,769</b>	<b>8,066</b>
<b>B - Baza e rregulluar e asetëve</b>	<b>Mln leke</b>	<b>45,050</b>	<b>46,249</b>	<b>46,993</b>	<b>138,292</b>
<b>WACC (sipas Vendimit të ERE për tarifen 2022-2024)</b>	<b>%</b>	<b>2.28%</b>	<b>2.28%</b>	<b>2.28%</b>	<b>2.28%</b>
<b>R - Kthimi mbi kapitalin (R = B*WACC)</b>	<b>Mln leke</b>	<b>1,027</b>	<b>1,054</b>	<b>1,071</b>	<b>3,153</b>
<b>C kapital= R+D</b>	<b>Mln leke</b>	<b>3,637</b>	<b>3,742</b>	<b>3,840</b>	<b>11,219</b>
<b>C - Ardhurat kerkuara (C operuese + C kapital)</b>	<b>Mln leke</b>	<b>11,575</b>	<b>11,817</b>	<b>12,333</b>	<b>35,725</b>
<b>Te ardhurat nga aktivitetet tjera</b>	<b>Mln leke</b>	<b>3,629</b>	<b>3,134</b>	<b>1,928</b>	<b>8,690</b>
Ardhura tjera që zbriten nga të ardhurat e kerkuara	"	1,805	1,935	1,995	5,735
Rregullime për periudhat e meparshme rregullatore	"	1,824	1,199	-67	2,955
<b>Ardhurat kerkuara neto</b>	<b>Mln leke</b>	<b>7,947</b>	<b>8,683</b>	<b>10,405</b>	<b>27,035</b>
<b>Tarifa mesatare e transmetimit</b>	<b>leke/kWh</b>	<b>1.07</b>	<b>1.18</b>	<b>1.41</b>	<b>1.22</b>

Burimi: OST sh.a.

Kërkesa e OST sh.a. përmban një nivel të ardhurash të kërkuara prej 7,947 milion lekë për vitin 2025, duke vijuar me 8,683 milion lekë për 2026 si dhe 10,405 milion lekë për vitin 2027. Tarifa mesatare e propozuar për shërbimin e transmetimit të energjisë elektrike për periudhën rregullatore 2025 – 2027 është **1,22 lekë/kWh**, pra me një rritje në masën 44% në krahasim me tarifën aktuale. Shoqëria OST sh.a. sqaron se: “Aplikimi ka për qëllim të pasqyrojë nevojën për rishikimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike, tarifë e cila do të bëjë të mundur ushtrimin e aktivitetit normal të Operatorit të Transmetimit të Energjisë Elektrike”.

Në kapitullin IX. të Aplikimit OST sh.a. ka argumentuar:

“Bazuar në metodologjinë aktuale të llogaritjes së tarifës së transmetimit të energjisë elektrike, të ardhurat e kërkuara i ngarkohen konsumit të energjisë elektrike të furnizuar ndaj konsumatorëve dhe jo të gjithë përdoruesve të rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike”.

Në vijim, me tabelën e reflektuar më poshtë, shoqëria ka paraqitur vlerat faktike të energjisë që ka hyrë në rrjetin e transmetimit për periudhën 2022 – 2023, pritshmëritë e saj per vitin 2024 si dhe periudhën rregullatore 2025 – 2027.

Tabela 3: Përdorimi i rrjetit të transmetimit

PERDORIMI I RRJETIT	Njësia	2022	2023	2024	2022-2024	2025	2026	2027	2025-2027
Energjia në rrjetin e Transmetimit	GWh	9,547	10,147	10,296	29,990	10,553	10,684	10,833	32,069
Energjia e perdorur per furnizim	GWh	7,225	7,086	7,423	21,733	7,401	7,380	7,362	22,142
Energjia e perdorur per Jo-furnizim	GWh	2,323	3,062	2,872	8,257	3,152	3,304	3,471	9,927

**Burimi: OST sh.a.**

Referuar të dhënave të mësipërme, shoqëria ka përllogaritur se thuhetse 29% e energjisë elektrike që hyn dhe përdor rrjetin e transmetimit, nuk faturohet si shërbim transmetimi. Më tej OST sh.a.ka dhënë arsytimin:

*“Duke qenë se mirëmbajtja dhe zhvillimi i rrjetit të transmetimit, është një detyrim i OST sh.a., për të garantuar shërbimin e transmetimit të energjisë elektrike për të gjithë përdoruesit e këtij rrjeti, gjykojmë që është e rëndësishme që dhe alokimi i të ardhurave të kërkuara të bëhet në mënyrë të drejtë për të gjithë përdoruesit e rrjetit të transmetimit.”*

Mbështetur në këtë arsyetim, shoqëria ka kryer një vlerësim mbi shpërndarjen e të ardhurave të kërkuara për llogaritjen e tarifës së transmetimit për periudhën rregullatore 2025 - 2027, duke marrë për bazë peshën specifike të energjisë elektrike që hyn në rrjetin e transmetimit sipas energjisë për furnizim dhe asaj për jo-furnizim.

Tabela 4: Të ardhurat e kërkuara të ndara sipas peshës që zë energjia që hyn në rrjet për qëllime furnizimi dhe jo - furnizimi

		2022	2023	2024	2022-2024	2025	2026	2027	2025-2027
<b>Ardhurat kerkuara neto</b>	Mln leke	<b>5,875.26</b>	<b>6,050.02</b>	<b>6,309.71</b>	<b>18,234.99</b>	<b>7,946.86</b>	<b>8,683.00</b>	<b>10,405.13</b>	<b>27,034.99</b>
<i>Te ardhurat e Kerkuara Furnizim</i>	<i>Mln leke</i>	<i>4,446</i>	<i>4,225</i>	<i>4,549</i>	<i>13,220</i>	<i>5,573</i>	<i>5,998</i>	<i>7,071</i>	<i>18,642</i>
<i>Te ardhurat e Kerkuara Jo-Furnizim</i>	<i>Mln leke</i>	<i>1,429</i>	<i>1,826</i>	<i>1,760</i>	<i>5,015</i>	<i>2,374</i>	<i>2,685</i>	<i>3,334</i>	<i>8,393</i>

**Burimi: OST sh.a.**

Duke cituar shoqërinë, nëse të ardhurat e kërkuara do t'i ngarkoheshin të gjithë përdoruesve të rrjetit, tarifa mesatare e transmetimit gjatë periudhës rregullatore 2025 - 2027 do të rezultonte mesatarisht 0.38 leke/kWh më e ulët sesa tarifa mesatare e rezultuar në versionin e parë, sipas metodologjisë aktuale (nga 1.22 lekë/kWh në 0.84 lekë/kWh). Në rast se do të aplikohet kosto mesatare e ponderuar e kapitalit, e propozuar nga OST sh.a. për periudhën e ardhshme rregullatore, atëherë kjo tarifë do të rezultonte mesatarisht 0.43 lekë/kWh më e ulët sesa tarifa mesatare e përllogaritur në versionin e dytë, sipas metodologjisë aktuale (nga 1.38 leke/kWh në 0.95 lekë/kWh).

Në lidhje me propozimin e mësipërm të paraqitur nga OST sh.a. në Aplikim, Shoqata Shqiptare e Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES), si dhe Shoqata e prodhuesve të energjisë së rinovueshme të Shqipërisë (AREA), me anë të shkresës nr. 2110 prot, datë 21.10.2024 (përcjellë me e-mail më datë 22.10.2024) dhe shkresës nr. 1810/230, datë 05.12.2024 (dërguar me e-mail me datë 05.12.2024) kanë përcjellë komentet e tyre.

AAES është shprehur se, përpos argumentit se alokimi i të ardhurave të kërkuara sipas peshës që zë energjia që hyn në rritjet për qëllime furnizimi dhe jo - furnizimi bie ndesh me përcaktimet e Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe aplikimi i një tarife transmetimi për energjinë e tregtuar do të ishte një hap prapa në zhvillimin e tregut të energjisë elektrike duke patur impakt tejet negativ në këtë të fundit. Ndër të tjera, AAES shton se aplikimi i propozimit të OST sh.a.:

*“Impakti i parë do të ishte një rritje e çmimeve të energjisë në të gjithë vendin dhe në të gjitha llojet e aktivitetit. Kjo rritje do të afektonte energjinë e tregtuar në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike (APLEX), energjinë e tregtuar lirisht mes paleve në tregun OTC, importin, eksportin dhe tranzitimin e energjisë elektrike.*

*Shtrirja e aplikimit të tarifës së OST për energjinë e tregtuar APLEX bie ndesh me parirnet e “Market Coupling”, si dhe përballet me veshtirësitë teknike në implementim (identifikimin e sasive) ku si shëmbull mjafton të përmëndim energjinë e tregtuar në APLEX. Ngrihet pyetja se cilat sasi të tregtuara në ALPEX do të jenë subjekt i tarifës së transmetimit. Duke supozuar që tarifa do të aplikohet vetëm për sasi të tregtuara në Shqipëri, atëherë do të kishim jo vetëm “diskriminim tarifor” të këtyre sasive, por do të gjëndeshim para një “bariere” izoluese të ALPEX në Shqipëri nga tregjet e tjera.”*

*Impakti i dytë do të ishte rritja e çmimit të energjisë për konsumatorët fundorë pasi Furnizuesit e Kualifikuar, në kontrast me ç’ka është situata sot, do të ishin të detyruar të blejnë energji elektrike subjekt i tarifës së transmetimit (përpara se të lëvrohet te konsumatorët).*

*Impakti i tretë që vlen të përmendet është konfuzioni. Gjendur në pamundësinë thujse absolute të gjurmueshmërisë së energjisë së tregtuar, e njehta sasi energjie riskon të tarifohet më shumë se 1 herë, duke qenë se ajo mund të tregtohet ndërmjet dy apo më shumë tregtarësh. Një situatë e tillë do të sillte konfuzion/pasiguri në aktivitetin mes aktorëve prezent në tregun vendas por edhe në marrëdhëniet e tyre me organet tatimore.*

*Pa dashur të shprehim gjykimin apo arrijmë në konkluzione të gabuara, mendojmë se shifrat më !art nuk reflektojnë situatën reale dhe kjo argumentuar si vijon:*

- pika a) më !art, së paku, nuk konsideron çmimet e pritshme të energjisë për periudhën 2025 – 2027, të cilat janë dukshëm në nivel më të ulët se vitet më parë.
- pika b) më !art nuk merr në konsideratë Raportin e Aktivitetit. Në Raportin e Aktivitetit të OST për periudhën Janar- Qershor 2024, OST raporton se kostoja për blerjen e shërbimeve ndihmëse ishte planifikuar në rreth 620 milionë Lekë, ndërkohë vlera faktike është 232,8 milion Lekë. Thënë ndryshe, vetëm për 6 mujorin e parë të vitit 2024, janë shpenzuar rreth 387 milion lekë më pak nga sa ishte parashikuar. Dukshëm, parashikimi nga OST për rritje të kostos për shërbimet ndihmëse nuk është i vlefshëm.
- Së fundmi, në raportin e OST bie në sy edhe fakti se OST priste 0 lekë të ardhura nga tregu i balancimit, por vetëm në 6 mujorin e parë të këtij vitit OST ka siguruar të ardhura prej rreth 763 milion lekë. Kjo situatë është dukshëm në kundërshti me parashikimet e Rregullave të Tregut të Balancimit, sipas të cilave OST duhet të ketë një

*pozicion neutraliteti financiar! Në përgjigjen e saj ndaj ERE-s, Nr. 6004 /2 Prot., datë 10.07.2024 OST nuk përfshin pozicionin e saj neto të siguruar nga aktiviteti i tregut të balancimit, thënë ndryshe fitimin. Në opinionin e AAES, parashikimi i Rregullave të Tregut të Balancimit (neni 3.6.a. l) në lidhje me rezultatet neto të disbalancave me PPB-të nuk është marrë në konsideratë nga OST.”*

Ndërkohë, “Albanian Renewable Energy Association” AREA është shprehur se:

*“...sugjerimin për të vendosur këtë tarifë, për të gjithë përdoruesit e rrjetit ku nuk thuhet qartë nëse kjo do të përfshinte edhe prodhuesit e energjisë. Për këtë kërkesë të sqarohet se çfarë ka dashur të thotë me përdorues rrjeti, ndërkohë që në tarifën e transmetimit përjashtohen eksporti, aksesit në rrjetin e energjisë së prodhuar.*

*Gjithashtu shikojmë se kërkesa për rritje të tarifës së transmetimit është e paargumentuar sepse është e pambështetë nga pasqyrat financiare edhe të vitit aktual dhe nuk jep një analizë të çfarë ndikimi do të kishte ky ndryshim në aktorët e tjerë që janë pjesëmarrës të tregut të energjisë, furnizuesit dhe së fundmi konsumatorët. Gjithashtu, vëmë re se megjithëse OST ka siguruar të ardhura jo të vogla nga tregu i balancimit (të ardhura këto që duhet të ishin shpërdarë sipas rregullave) ne vuajmë akoma nga një mungesë transparence të të dhënave për tregun e balancimit ku pjesëmarrësit nuk kanë informacion sa duhet për çmimin e disbalancave dhe sasive dhe çmimeve të ankandëve gjë e cila e bën të pamundur hartimin e modeleve për të llogaritur çmimet e disbalancave për ditën në vijim apo brenda ditës. Kjo është akoma më shumë shqetësuese për PP që do dalin në treg të lirë ku menaxhimi i disbalancave të tyre në këto kushte është shumë i vështirë për tu menaxhuar....”*

Sa më sipër, komentet e përcjella nga palët e interesit u diskutuan dhe gjatë seancës publike të zhvilluar me datë 06.12.2024, ku OST sh.a. u shpreh se mbështetur në argumentet e paraqitura në Aplikim, kërkon miratimin e tarifës së transmetimit të propozuar me qëllim mbulimin e kostove të aktivitetit të transmetimit. Më tej, shoqëria shtoi se, në zbatim të parimeve të metodologjisë në fuqi, propozimi i paraqitur merr në konsideratë dy variante, të cilat janë bazuar në dy skenarë të ndryshëm. Komponenti i vetëm që ndryshon në dy variantet e propozuara është kostoja mesatare e ponderuar e kapitalit (WACC). Në variantin e parë të propozuar me WACC të miratuar sipas vendimit të bordit të ERE nr. 72/2022, rezulton një tarifë prej 1.22 lekë/kWh ndërsa në variantin e dytë, ku është konsideruar WACC i përllogaritur dhe i propozuar nga shoqëria kërkohet një tarifë prej 1.38 lekë/kWh.

Lidhur me çështjen në të cilën janë fokusuar komentet e palëve të sipërcituara, përfaqësuesit e OST sh.a., deklaruan se shoqëria ka pasur për qëllim adresimin e këtij shqetësimi ndaj instancave të tjera sa i takon faturimit të tarifës së transmetimit për përdorimin e rrjetit. Sipas tyre, kjo çështje nuk lidhet me propozimin e shoqërisë për tarifën e transmetimit të energjisë elektrike, për periudhën e ardhshme rregullatore.

Procesi i analizimit të Aplikimit të shoqërisë OST sh.a. është mbështetur mbi parimet dhe rregullat e vendosjes së tarifës, të përcaktuara në dispozitat e Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, si dhe në “Metodologjinë e llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 180, datë 08.11.2017.

Në këtë kuadër, në kryerjen e vlerësimeve ERE ka konsideruar kostot operative dhe kapitale të arsyeshme, të matshme dhe reale me qëllim përcaktimin e një tarife kosto–reflektuese, transparente dhe që garanton sigurinë e operimit të rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike.

**Në vijim paraqesim konstatimet dhe vlerësimet e kryera nga shqyrtimi i aplikimit, korrespondencave dhe materialeve plotësuese, të dërguara nga OST sh.a. në kuadër të këtij procesi, duke evidentuar diferencat në vlera për çdo komponent përllogaritës të të ardhurave të kërkuara:**

## I. SHPENZIMET OPERATIVE (OPEX)

Tabela në vijim pasqyron krahasimin mes vlerave të grup-shpenzimeve operationale të paraqitura nga shoqëria krahas konsiderimeve/vlerësimeve të kryera nga ERE, për vitin 2024 si dhe parashikimeve për periudhën 2025 – 2027.

Tabela 5: Kostot operative të paraqitura nga shoqëria OST sh.a. në aplikim dhe vlerësimet/pranimet e kryera nga ERE

Zeri	Aplikimi i OST								Pranimet e ERE						
	Realizuar nga OST 2022	Realizuar nga OST 2023	Realizuar nga OST 2024	Mesatare 3 vjecare	Parashikim 2025	Parashikim 2026	Parashikim 2027	Mesatare 3 vjecare	Pranimet e ERE mbi realizimin 2022	Pranimet e ERE mbi realizimin 2023	Pranimet e ERE për 2024	Parashikim 2025	Parashikim 2026	Parashikim 2027	Mesatare 3 vjecare
Mirembajtje									153	164	161	164	169	174	169
Shpenzime materiale	116	103	119	113	167	169	171	169	117	104	73	101	104	107	104
Personeli	1,247	1,201	1,519	1,323	1,690	1,736	1,784	1,737	1,260	1,218	1,438	1,549	1,595	1,643	1,595
Blerje energji per humbjet	3,116	2,124	1,940	2,393	2,549	2,366	2,222	2,379	3,116	2,124	1,940	2,428	2,277	2,163	2,289
Shërbime ndihmese	535	806	1,101	814	1,759	1,947	2,377	2,028	534	806	416	615	645	678	646
menaxhim kongjestion me ridispecerim	-	-	-	-	654	719	785	719							
CBT	231	378	314	307	300	300	300	300	230	377	283	300	300	300	300
Furnitura dhe Shërbime	947	1,086	764	932	820	836	853	836	486	571	500	534	550	567	551
<b>Totali i OPEX</b>	<b>6,191</b>	<b>5,698</b>	<b>5,756</b>	<b>5,882</b>	<b>7,939</b>	<b>8,074</b>	<b>8,493</b>	<b>8,169</b>	<b>5,895</b>	<b>5,363</b>	<b>4,811</b>	<b>5,690</b>	<b>5,640</b>	<b>5,632</b>	<b>5,654</b>

**Burimi: ERE**

### Shpenzimet e personelit

Vlera e kërkuar nga OST sh.a. për zërin “Shpenzime personeli” për vitin 2025 parashikohet me një rritje prej 11.2% në krahasim me vlerën e pritshme për mbylljen e vitit 2024. Më tej, për vitet 2026 dhe 2027, shoqëria i përllogarit “shpenzimet e personelit” duke u bazuar në kostot e parashikuara të këtij zëri për vitin respektiv paraardhës, të indeksuara me normën e synuar të inflacionit prej 3%. Nga të dhënat e aplikimit u konstatua gjithashtu se: krahasuar me kostot faktike të këtij zëri të gjashtë mujorit të parë të 2024, në gjysmën e dytë të vitit, shoqëria pret një rritje të këtij shpenzimi në masën rreth 23%.

Në lidhje me sa konstatuar, ERE në korrespondencën nr. 1859/3 prot., datë 20.09.2024, i kërkoi shoqërisë paraqitjen e llogarive analitike të shpenzimeve operative në tërësi si dhe dhënien e arsyetimeve/argumenteve mbi rritjen e planifikuar. Gjithashtu, me qëllim kryerjen e një vlerësimi sa më të drejtë OST sh.a. duhej të depozitonte organigramën e plotë të shoqërisë si dhe borderonë e pagave të muajit gusht 2024, në të cilën të evidentoheshin qartë komponentët përbërës të shpenzimeve te personelit.

OST sh.a. me shkresën nr. 6004/2 prot., datë 07.10.2024, protokolluar me tonën me nr. 1859/4 prot., datë 09.10.2024, ka sqaruar se me vendimin e Këshillit Mbikqyrës nr. 03, të datës 16.05.2024, “Për disa ndryshime në strukturën e pagesave të OST sh.a.”, janë miratuar disa ndryshime në pagat dhe trajtimet e personelit të OST sh.a. të tilla si:

- Rritjen e pagës bazë të punonjësve duke filluar nga data 1 maj 2024,
- Indeksimin vjetor të pagave me normën e publikuar të inflacionit, duke filluar nga data 1 janar 2025.

Më tej, shoqëria ka shtuar se, me shkresën nr. 10027/1prot., datë 05.08.2024, të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, me lëndë “Miratimi i ndryshimeve në programin e Zhvillimit Ekonomik të OST sh.a”, ka miratuar shtimin e numrit të punonjësve për vënien në punë dhe operimin e Nënstacionit të ri, Hoxharë, me 11 (njëmbëdhjetë) punonjës, sipas vendimit nr. 8, datë 18.07.2024 të Këshillit Mbikëqyrës së OST sh.a.. Efektet e hyrjes në fuqi të vendimeve të cituara janë reflektuar në rritjen e kostove të parashikuara të këtij grupshpenzimi për pjesën e mbetur të vitit 2024 si dhe për periudhën 2025 – 2027.

Dokumentet e mësipërme dhe organigrama e shoqërisë i janë bashkëlidhur korrespondencës së sipërcituar të OST sh.a.

Referuar të dhënave të Aplikimit si dhe korrespondencës nr. 6004/2 prot., datë 07.10.2024 (protokolluar me tonën me nr. 1859/4 prot., datë 09.10.2024), ku janë përfshirë llogaritë analitike të këtij zëri, OST sh.a. parashikon gjithashtu rritje të kostove si:

- “Shtesa turni dhe orë jashtë orari”;
- “Udhëtime dhe dieta”;
- “Shpenzime të tjera personeli”;

Bazuar në dispozitat e “Metodologjisë së llogaritjes së Tarifës së Transmetimit të Energjisë Elektrike”, në këtë zë duhet të njihen pagat, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore dhe kostot (të ndryshme nga taksat) të lidhura me programet në përfitim të të punësuarve. Lidhur me shpenzimet e cituara më sipër, vlerësojmë se zëri ‘udhëtime dhe dieta’ nuk duhet të përfshihet në përlllogaritjen e shpenzimeve të personelit.

Konform nenit 7, pika 2 dhe 3, e “Metodologjisë së llogaritjes së Tarifave të Transmetimit të energjisë elektrike”, përcaktohet se rregullimet në vitin e testimit duhet të konsiderojnë indeksimin bazuar në normën e inflacionit. Gjithashtu, OST duhet të paraqesë justifikime për çdo rregullim/korigjim të parashikuar të rezultateve të vitit të testimit. Rregullimet duhet të specifikohen në tabelat e paraqitura nga OST në aplikimin për tarifë, si dhe dëshmi me shkrim duke dhënë prova për arsyet dhe nivelin e çdo korigjimi/rregullimi. Sa më sipër, OST sh.a. e ka mbështetur propozimin e saj për zërin “shpenzime personeli” në vendimet e sipërcituara të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë.

Vlerësimi ynë lidhur me parashikimin e realizimit të këtij shpenzimi për vitin 2024 është mbështetur përlllogaritjen e katër muajve të parë, janar - prill, në mesataren mujore të këtij shpenzimi të realizuar përgjatë vitit 2023, ndërkohë që për periudhën maj – dhjetor 2024 është konsideruar realizimi i këtij grup shpenzimi sipas strukturës së re të pagave. Kosto e përlllogaritur sipas strukturës së re të pagave është konsideruar për vitin 2025, ndërkohë që për vitet 2026 dhe 2027 ky shpenzim është përlllogaritur duke aplikuar një rritje prej 3% mbështetur

në normën e synuar të inflacionit të Bankës së Shqipërisë sikurse evidentohet në tabelën e mësipërme.

### **Shpenzime materiale të para**

Në aplikimin e përcjellë në ERE, shoqëria OST sh.a për këtë zë shpenzimesh parashikon një kosto mesatare vjetore prej 169 milion lekë për periudhën rregullatore 2025 – 2027. Referuar kostove faktike të këtij shpenzimi për muajt janar – gusht 2024, rezulton se janë në shumën 49 milion lekë, ndërkohë që pritshmërinë e mbylljes së këtij viti, shoqëria e parashikon në vlerën 119 milion lekë, vlerë e cila krahasuar me koston mesatare vjetore të kërkuar nga OST sh.a për periudhën 2025 – 2027, rezulton 42% më e ulët.

Me korrespondencat e sipërcituara OST sh.a. ju kërkua paraqitja në formë analitike e kostove faktike të këtij shpenzimi të muajve janar – gusht 2024, si dhe kostove të parashikimeve për periudhën e mbetur të 2024 dhe të viteve 2025 – 2027. Ky informacion duhet të shoqërohet me argumenta mbi të cilat bazohet parashikimi i paraqitur si dhe dokumentacion justifikues.

Në shkresën me nr. 6004/2 prot., datë 07.10.2024, protokolluar me tonën me nr. 1859/4 prot., datë 09.10.2024, OST sh.a. sqaroi se:

*“Lidhur me parashimin në rritje të zërit të shpenzimeve për materialet e para janë bërë vlerësimet duke marrë në konsideratë ecurinë e deritanishme si dhe kontratat e reja të cilat OST sh.a. ka parashikuar të realizojë gjatë vitit 2025.”*

Referuar të dhënave të paraqitura në aplikim si dhe pasqyrave financiare të secilës periudhë ushtrimore, evidentohet se realizimi i këtij zëri është 117 milion lekë në vitin 2022 dhe 104 milion lekë në vitin 2023. Ndërkohë, për vitin e testimit 2024 është marrë referencë mesatarja mujore e realizuar në periudhën janar – gusht, e përlllogaritur për 12 muaj. Nisur nga kostot historike të shpenzimeve për materialet të para, vlerësojmë se për përlllogaritjen e vlerës së vitit bazë 2025 duhet të merret mesatarja e ponderuar e realizimit të këtij zëri në periudhën 2022 – 2024, e indeksuar me normën e synuar të inflacionit prej 3%. Më tej, në analogji me sa aplikuar edhe për zërin “shpenzime personeli”, për vitet 2026 dhe 2027, ky zë është përlllogaritur duke u bazuar sërish në parashikimin e vitit paraardhës respektiv, të indeksuar me normën 3% sikurse evidentohet në tabelën e mësipërme.

### **Menaxhimi i kongjestionit me ridispeçerim**

Shoqëria ka parashikuar dhe përfshirë në aplikimin për periudhën rregullatore 2025 - 2027 zërin e shpenzimeve “Menaxhimi i kongjestionit me ridispeçerim”, duke argumentuar si më poshtë:

*“..për të çliruar konxhestionin në rrjet, në rastet kur shfaqet, aplikohet ridispecimi, që nënkupton uljen e gjenerimit në një pikë të caktuar të injektimit në rrjet, dhe rritjen respektive të gjenerimit në një pikë tjetër të injektimit në rrjet, ose sipas rastit vetëm uljen apo rritjen e gjenerimit në funksion të konxhestionit të krijuar. Ky ndryshim i gjenerimit, krahasuar me programin e kontraktuar që ka deklaruar pjesmarresi përkatës në treg, duhet të kompensohet nga OST, si në rastin e uljes, ashtu edhe në rastin e rritjes së gjenerimit, për një periudhë të caktuar kohore që vlerësohet nga Operatori*

Për përmasat e Sistemit tonë është vlerësuar i mjaftueshem kapaciteti prej 100 MW ( $\pm 50$  MW). Numri i ditëve potencialisht të mundëshme për aplikimin e ridispecimit është marrë 100, dhe me një kohëzgjatje të mundëshme prej 6 orë, për çdo rast ridispecimi. Çmimi i këtij lloj shërbimi është marrë i përafërt me çmimin e injektimit të energjisë nga PPE-të me koncension.”

Tabela 6: Parashikimi i zërit “Menaxhimi i kongjestionëve”

Viti	Kapaciteti [MW]	Nr. Ditëve	Kohezgjatja në ore per çdo ditë të mundëshme	Sasia [MWh]	Cmimi mesatar [€/MWh]	Fondi [€]	Fondi [Mln Leke]
2025	100	100	6	60,000	108.5	6,507,600	654
2026	100	100	6	60,000	119.2	7,154,215	719
2027	100	100	6	60,000	130.2	7,810,930	785

Burimi: OST sh.a.

Nga të dhënat e aplikimit, parashikimi i shoqërisë për këtë shpenzim është llogaritur me një kosto mesatare për periudhën rregullatore 2025 - 2027 prej 719 milion lekë.

Referuar të dhënave faktike të periudhave të mëparshme ushtrimore, pavarësisht se në rregullat e tregut të balancimit kapitulli 9, pika 9.5, është e përcaktuar se: “OST do të ketë detyrimin që të përdorë ofertat me kohë aktivizimi më të gjatë se 30 minuta”, ekskluzivisht për menaxhimin e kongjestionit, rezulton se ky shpenzim nuk ka ndodhur ndonjëherë. Në këto rrethana shoqërisë i është kërkuar në korrespondencën nr. 1859/3 prot., datë 20.09.2024, si dhe gjatë diskutimit të zhvilluar në seancën teknike, se mbi të cilat argumente e ka bazuar parashikimin dhe paraqitjen e kërkesës për këtë zë. Ndër të tjera shoqëria ka sqaruar se:

*“Menaxhimi i kongjestionëve me ridispecerim, është detyrim për OST prej datës 01.04.2021 me hyrjen në fuqi të Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike. Në zbatim të dispozitave të Kodit të Transmetimit, neni 103 pika 1 gërma e), OST sh.a mund ta aplikojë Menaxhimin e kongjestionëve me ridispecerim te energjisë elektrike nga centralët prodhuese në funksion të sigurisë së punës së Sistemit dhe sigurisë së furnizimit, pa ndikuar në detyrimet kontraktore të furnizimit me energji elektrike.*

*Hyrja në fuqi me Vendimin Nr. 106 /2020 ERE të “Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike” nuk i lë më hapësira OST ta kërkojë këtë shërbim të përdoruesit e rrjetit...*

*...me qëllimin e përmbushjes së këtij detyrimi, nga ana e OST sh.a. është kërkuar dhe në periudhat e mëparshme njohja dhe përfshirja e këtyre kostove në tarifën e transmetimit, në mënyrë që të bëhej e mundur sigurimi i fondeve të nevojshme për kontraktimin e këtij shërbimi, ku e vetmja mundësi për disponibilitetin e fondeve është përfshirja në të ardhurat e kërkuara nëpërmjet tarifës së transmetimit.”*

Pika 2, neni 7, në “Metodologjinë e Llogaritjes së Tarifave të Transmetimit të Energjisë Elektrike” miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 180, datë 08.11.2017, përcakton se: Fondet e planifikuara për mbulimin e kostove të ngjarjeve të pasigurta apo të pa parashikuara, nuk do të miratohen nga ERE.

Sa më sipër parashtruar, sqarojmë se megjithëse shoqëria prej prillit të vitit 2021 operon me Rregullat e Reja të Tregut të Balancimit, deri më tani OST nuk ka patur asnjëherë shpenzime për zërin “Menaxhimin e kongjestionit me ridispecerim”. Për rrjedhojë, këtë zë shpenzimi e

vlerësojmë si një ngjarje të pasigurtë dhe si e tillë nuk mund të konsiderohet në të ardhurat e kërkuara si një fond rezervë, i cili e afekton ndjeshëm përlllogaritjen e tarifës së transmetimit për periudhën 2025 - 2027.

### **Blerja e shërbimeve ndihmëse**

OST sh.a. ka parashikuar të realizojë shpenzime nga “blerja e shërbimeve ndihmëse” për periudhën rregullatore 2025 – 2027 me një kosto mesatare vjetore prej 2,028 milion lekë. Referuar realizimit të këtij shpenzimi për periudhës 2022 - 2023, evidentohet se ky shpenzim është realizuar në vlerën 535 milion lekë në vitin 2022 dhe 806 milion lekë në vitin 2023 (ose 51% më e lartë se sa realizimi i vitit paraardhës). Ndërkohë që, bazuar në aplikim, parashikimi i shoqërisë për mbylljen e vitit 2024 paraqitur në vlerën 1,101 milion lekë.

Nisur nga krahasimi i realizimit të këtij zëri në periudhat paraardhëse me parashikimin e kryer për periudhën e mbetur të vitit 2024, si dhe 2025 - 2027, nga i cili u evidentua një trend në rritje, ERE me shkresën nr. 1859/3 prot., datë 20.09.2024, i kërkoi OST sh.a. paraqitjen e analizave, arsyetimeve si dhe evidencave mbi kapacitetet e përdorura në periudhat e mëparshme, krahas kapaciteteve të parashikuara për t'u përdorur në periudhën e propozuar rregullatore. Këto të dhëna duhet të shoqëroheshin me argumentet dhe shpjegimet përkatëse.

OST sh.a. me shkresën nr. 6004/2 prot., datë 07.10.2024, protokolluar me tonën me nr. 1859/4 prot., datë 09.10.2024,, sqaroi se:

*“Për sa i përket parashikimeve të sasive të kapaciteteve për shërbimet ndihmëse ju bëjmë me dije se: Angazhimi i burimeve për të mbajtur frekuencën e rritit në nivelin e pranueshëm, organizohet nëpërmjet katër produkteve balancuese FRC,aFRR,mFRR,RR. (shërbime ndihmëse). OST aktualisht prokuron vetëm ( $\pm aFRR$ ) në rritje dhe në ulje.*

*Rezervat e mbajtjes së Frekuencës (FCR), njohur gjithashtu si rezervat e rregullimit primar, nuk prokurohet nga OST sepse asnjë nga OSHB nuk përmbush kushtet teknike për ofrimin e këtij shërbimi. Ndërsa për rezervën zëvendësuese (manuale) mFRR dhe RR nuk është prokuruar sepse kërkesat për balancim deri më tani janë plotësuar nëpërmjet ( $\pm aFRR$ ).*

*Rezerva mFRR dhe RR mund të prokurohet në vitet në vijim, në varësi të zhvillimit dhe ndryshimeve që pëson Sistemi i Transmetimit, ajo përcaktohet në funksion të risqeve operacionale që shoqërojnë sigurinë e operimit të sistemit (regjime eksporti apo importi të larta). Parashikohet në atë masë që të mund të sigurojë zbutjen/eliminimin e ndikimit të incidentit duke mos lejuar përhapjen e shqetësimit të krijuar drejt sistemeve fqinje të transmetimit (kriteri i mbulimit të gjeneratorit me fuqi më të madhe i angazhuar në operim).*

*Rezerva ( $\pm aFRR$ ) e cila prokurohet dhe ka ndikim në tarifë përlllogaritjet nga OST në përputhje me Manualin e Operimit të ENTSO-E gjithashtu duke patur në konsideratë vlerat e devijimeve historike. Masa e sigurimit të tyre merr në konsideratë llogaritjet duke përdorur si variabël ngarkesën e vendit në rastin e rezervave automatike të rivendosjes së frekuencës.*

*Kërkesa e OST mbi sasinë e nevojshme për kapacitetin rezervë, përditësohet çdo vit. Trendi në rritje i rezervave kryesisht diktohet nga rritja e devijimeve në balancën e sistemit si pasojë e integritetit të burimeve të rinovueshme, të cilat kanë luhajtje të konsiderueshme në prodhimin e tyre.”*

Tabela 7: Prokurimi i kapacitetit rregullues dhe atij rezervë për shërbimin e balancimit

Produkti	Viti 2025			Viti 2026			Viti 2027		
	Sasia	Çmimi mesatar	Fondi	Sasia	Çmimi mesatar	Fondi	Sasia	Çmimi mesatar	Fondi
	[MW]	[€/MW]	[€]	[MW]	[€/MW]	[€]	[MW]	[€/MW]	[€]
aFRR+	254,239	47.43	12,058,554	266,951	49.99	13,345,728	280,298	58.13	16,293,692
aFRR-	151,080	36.64	5,536,087	158,634	38.62	6,127,029	166,566	44.91	7,480,441
<b>Total</b>	<b>405,319</b>	<b>43.41</b>	<b>17,594,641</b>	<b>425,585</b>	<b>45.76</b>	<b>19,472,757</b>	<b>446,864</b>	<b>53.20</b>	<b>23,774,133</b>

**Burimi: OST sh.a.**

Duke qenë se sqarimi i paraqitur nga shoqëria nuk ishte shterues në lidhje me sa kërkuar nga nga ERE, në seancën teknike të zhvilluar më datë 28.10.2024, u kërkuar sërish nga pala përfaqësuese e shoqërisë OST sh.a. dhënia e shpjegimeve në lidhje me parashikimin e kryer për këtë zë, si dhe arsyet e rritjes së këtij shpenzimi me 51 % më shumë në vitin 2023 sesa realizuar gjatë 2022. Në lidhje me këtë çështje, përfaqësuesit e shoqërisë u shprehën se:

*“Rritja e injektimit të energjisë nga burimet e rinovueshme fotovoltaike nuk avantazhon balancimin e sistemit krahasuar me burimet e tjera. Rrjedhimisht në parashikimet e kryera është marrë në konsideratë një marzh më i madh i disbalancave me të cilat do të përballet sistemi.*

*Në kuadër të politikës të diferencimit të burimit të energjisë elektrike të rinovueshme gjatë këtyre 3 viteve, shoqëria është përbaluar me një “boom” aplikimesh për burimet fotovoltaike dhe eolike. Në muajin maj të vitit 2022 është lidhur në rrjetin e transmetimit impianti PV i KESH-it, duke u pasuar nga impianti i Karavastasë, i cili ka një kapacitet 140 MW.*

*Aktualisht, sipas deklaratës së përfaqësuesve të shoqërisë, në rrjetin e transmetimit janë lidhur edhe 100 MW të tjerë, duke e çuar vlerën e fuqisë së instaluar në 250 MW. Rrjeti i shpërndarjes është gjithashtu i atakuar nga fotovoltaiket (PV). Duke qenë se fotovoltaiket janë burime të ndryshueshme në kohë dhe të paparashikueshme, rrisin probabilitetin për shkaktimin e disbalanca, fenomen me të cilin sipas shoqërisë po përballet tashmë.*

*Referuar, rrjetit të shpërndarjes, ku ka dy kategori: prodhues fotovoltaike dhe vetëprodhues, rezulton që fuqia e instaluar është 170 MW. Sipas deklaratës së përfaqësuesve të shoqërisë pritet që deri në 2027 kapaciteti i fuqisë së instaluar të burimeve fotovoltaike të rritet nga 250 MW në 750 MW.”*

Me shkresën nr. 1859/12 prot., datë 20.11.2024, ERE ndër të tjera e adresoi sërish tek shoqëria kërkesën për paraqitjen e shpjegimeve, përllogaritjes dhe referencave mbi kostot e parashikuara.

Në përgjigje të sa më sipër, OST sh.a. me shkresën nr. 6004/7 prot., datë 02.12.2024, protokolluar me tonën me nr. 1859/19 prot., datë 03.12.2024 dha të njëjtën sqarim si në korrespondencën e parë duke shtuar se:

*“Rritja e rezervave diktohet kryesisht nga rritja e devijimeve në balancën e sistemit si pasojë e integritit të burimeve të rinovueshme, të cilat kanë luhatje të konsiderueshme në prodhimin e tyre.”*

Sa më sipër, në vijim të sqarimeve të dhëna gjatë seancës teknike si dhe përgjigjeve të dërguara nga OST sh.a. përmes korrespondencave të sipërcituara, vlerësojmë se kërkesa e shoqërisë për njohjen e këtij shpenzimi në periudhën rregullatore 2025 - 2027 mesatarisht në vlerën 2,028 milion lekë është e paarsyetuar. Mbështetur në kostot faktike të këtij zëri, të periudhës aktuale rregullatore 2022 - 2024 (ku viti 2024 është përlllogaritur me kostot e pritshme për mbylljen e kësaj periudhe ushtrimore) rezulton se ky shpenzim është realizuar në vlerën 586 milion lekë.

Sa më sipër, është konsideruar se vlera më përfaqësuese për parashikimin e këtij shpenzimi është kosto mesatare, e përlllogaritur duke u bazuar në të dhënat e realizimit për vitet 2022 – 2023, si dhe në koston e pritshme për mbylljen e vitit 2024. Parashikimi i mbylljes së vitit 2024 është kryer duke u mbështetur mbi mesataren e realizuar të këtij shpenzimi për muajt janar – gusht të kësaj periudhe ushtrimore. Ndërkohë, për vitin 2025 është marrë në konsideratë rezultati i koston mesatare 2022 - 2024 i indeksuar me një normë 5 përqind, vlerë e cila konsideron dhe efektin në rritje që mund të ketë ky shpenzim nga hyrja në operim e centraleve të reja prodhuese. Në lidhje me parashikimin për vitet 2026 dhe 2027 është konsideruar vitit paraardhës i indeksuar sërish me normën e rritjes prej 5 përqind sipas të njëjtit arsytim.

### **Pagesat ITC**

Për zërin “Shpenzime për ITC” OST sh.a parashikon që për secilin vit të periudhës rregullatore 2025 - 2027, ky shpenzim të jetë në vlerën 300 milionë lekë. Sipas shoqërisë, parashikimi bazohet në trendin disa vjeçar të pagesave ITC si dhe parashikimin e energjisë elektrike. Shoqëria deklaron se këto pagesa janë në proporcion të drejtë me marrëdhëniet e shkëmbimit të energjisë me shtetet e tjera dhe llogaritja e këtij zëri mbështetet në mekanizmin, Pan European Inter - TSOP Compensation, i cili është projektuar për të kompensuar palët për shpenzimet që lidhen me humbjet që rezultojnë nga bartja e flukseve të energjisë në sistemet e tyre.

Sa më sipër, për secilin vit të periudhës rregullatore, është marrë në konsideratë parashikimi i kryer nga shoqëria prej 300 milion lekë.

### **Shërbime administrative të tjera**

Nga të dhënat e përcjella në aplikim OST sh.a. pret të realizojë deri në fund të vitit 2024 “Shpenzime administrative e të tjera” në vlerën 764 milion lekë. Më tej, shoqëria i ka planifikuar kostot e këtij zëri në vlerën 820 milion lekë për vitin 2025, 836 milion lekë për vitin 2026 dhe 853 milion lekë për vitin 2027. Referuar këtij parashikimi, kosto mesatare e planifikuar për këtë grup shpenzimi për periudhën rregullatore 2025 – 2027 rezulton në vlerën 836 milion lekë. Me shkresën nr. 1859/2 prot., datë 20.09.2024, ERE i kërkoi shoqërisë paraqitjen në formë analitike të kostove faktike të çdo zëri komponenti përbërës të këtij grup - shpenzimi për vitin 2023 dhe periudhën janar - gusht 2024 si dhe parashikimet e kryera për periudhën e mbetur të vitit 2024 dhe periudhën e ardhshme rregullatore 2025 – 2027, të shoqëruar me argumentet përkatëse si dhe dokumentacionin justifikues.

OST sh.a. ka përcjellë me anë të shkresës nr.6004/2 prot, datë 07.10.2024 një tabelë ku evidentohen zërat përbërës të këtij grup shpenzimi si në vijim:

Tabela 8: Shpenzime administrative të tjera

N r	Shërbime administrative e të tjera	2023	8 mujori 2024	I pritshmi 2024	2025	2026	2027
1	Organizma Rajonale	87,875,506	76,996,271	138,813,209	131,000,000	137,550,000	144,427,500
2	Mirëmbajtje platforma, sisteme SOFTWARE, cyber, Europa kontinentale	348,621,329	107,089,376	194,931,773	189,392,000	198,861,600	208,804,680
3	Ruajtje Objekte	166,232,680	117,232,429	175,848,644	179,826,113	188,817,419	198,258,290
4	Mirëmbajtja e automjeteve	23,035,746	14,607,515	24,911,273	30,000,000	30,000,000	30,000,000
5	Automjete me qera	3,853,538	15,058,474	22,587,711	18,660,000	18,660,000	18,660,000
6	Sigurime	15,958,159	2,403,426	15,605,139	17,400,000	17,400,000	17,400,000
7	Mirëmbajtje ambjentesh	12,608,891	15,204,917	22,807,376	30,000,000	30,000,000	30,000,000
8	Kerkime studime	44,511,564	2,968,894	4,453,341	50,000,000	10,404,000	10,612,080
9	Eksperte Kontabel dhe Vleresues	61,690,000	17,706,000	25,156,000	30,000,000	30,000,000	30,000,000
10	Sherbim Teknik me jashte, aplikime, pjesmarrje	3,968,415	2,355,390	3,533,085	10,000,000	12,000,000	12,000,000
11	ERE	27,304,866	31,779,172	31,779,172	25,000,000	26,250,000	27,562,500
12	Kompesimi i disbalancave në rast të ndërprerjeve të energjisë në rrjetin e transmetimit si pasojë e avarive në sistem*				23,740,200	23,966,667	23,550,000
13	Sherbime mirembajtje dhe sherbime te tjera te telekomunikacionit	3,901,553	436,667	4,851,666.69	32,630,000	28,433,333	28,433,333
14	Shpenzime për pritje dhe përfaqësime	943,694	1,021,358	1,532,037	5,000,000	5,000,000	5,000,000
15	Trainime personeli	30,722,695	24,581,250	36,871,875	20,000,000	20,000,000	20,000,000
16	Keshilli Mbikqyres	3,770,730	2,772,491	4,158,737	4,173,600	4,298,808	4,427,772
17	Shpenzime për shërbimet bankare	1,638,930	1,284,360	1,926,539	2,500,000	2,500,000	2,500,000
18	Publicitet, reklama	276,869	122,000	183,000	1,400,000	1,500,000	1,500,000
19	Taksa, tatime dhe tarifa të tjera	9,426,713	3,234,587	8,024,379	15,000,000	15,000,000	15,000,000
20	Te tjera	239,330,752	44,546,275	45,803,333	4,000,000	35,000,000	25,000,000
<b>Totali Shërbimet administrative e të tjera</b>		<b>1,085,672,629</b>	<b>481,400,853</b>	<b>763,778,290</b>	<b>819,721,913</b>	<b>835,641,827</b>	<b>853,136,155</b>

Burimi: OST sh.a.

Nga shqyrtimi i pasqyrave financiare të periudhave ushtrimore paraardhëse, evidencave të përcjella në aplikim si dhe llogarive të paraqitura në përgjigjen e shkresës së sipërcituar, konstatojmë se, në këtë grup shpenzimi OST sh.a. klasifikon nën-llogari si:

- shpenzime periodike për mirëmbajtjen e platformave dhe sistemeve të ndryshme të operimit;
- shpenzime të mirëmbajtjes së godinave, mirëmbajtja e automjeteve;
- ruajtja e objekteve;
- shpenzimet e kryera nga të tretë për shërbime dhe mirembajtje,
- ujë;
- siguracione;
- pagesat e ERE etj.

Sqarojmë se: në përlllogaritjen e të ardhurave të lejuara, zërat e shpenzimeve që lidhen me mirëmbajtjen, konform përcaktimeve të nenit 7, pika 5, të “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmeimit”, njihen si komponent më vete. Bazuar në dispozitën e sipërcituar, nga shqyrtimi i pasqyrave financiare të viteve 2022 dhe 2023, si dhe parashikimet për mbylljen e vitit 2024, duke konsideruar vetëm llogaritë e klasifikuara nën këtë grup-shpenzim, rezulton se për 2022 ky zë është realizuar në vlerën 486 milion lekë, për 2023 në vlerën 571 milion lekë. Për parashikimin e këtij grup shpenzimi për mbylljen e vitit 2024, sikurse vepruar me komponentët mësipërm, është marrë në konsideratë, kosto mesatare faktike e periudhës janar

– gusht e përlogaritur për 12 muaj, nga përlogaritja e së cilave rezulton vlera 500 milion lekë.

Sa më sipër, në vlerësimet e kryera për vitin bazë 2025 janë konsideruar mesatarja e kostove historike të viteve 2022, 2023 si dhe pritshmëria për mbylljen e vitit 2024, e indeksuar me normën e nivelit të synuar të inflacionit prej 3%. Më tej për vitet 2026 dhe 2027, parashikimi bazohet mbi kostot ex-ante të vitit respektiv paraardhës, të indeksuar gjithashtu me normën e synuar të inflacionit prej 3%.

### **Mirëmbajtje dhe riparime**

Sikurse evidentuar dhe më lart, në aplikimin e shoqërisë nuk është parashikuar një zë i veçantë për “Shpenzimet e Mirëmbajtjes”. Këtë shpenzim shoqëria e ka përfshirë në grup shpenzimin “Shpenzime administrative e të tjera”. Nga analiza e pasqyrave financiare të periudhave ushtrimore 2022 dhe 2023, rezulton se ky shpenzim është realizuar në vlerën 153 milion lekë për vitin 2022 dhe 164 milion lekë për vitin 2023. Ndërkohë, referuar të dhënave të aplikimit, OST sh.a. për vitin 2024, pret që realizimi i këtij zëri të jetë 194 milion lekë.

Në vlerësimin tonë për vitin 2025, sikurse vepruar për “shpenzimet administrative e të tjera”, edhe për zërin “mirëmbajtje dhe riparime” është konsideruar mesatarja e kostove historike të viteve 2022, 2023 si dhe e pritshmërisë së mbylljes së vitit 2024 (e përlogaritur mbi mesataren mujore faktike të realizuar për periudhën janar – gusht), e indeksuar me normën 3%. Për vitet 2026 dhe 2027, është përlogaritur sërish mbi parashikimin e vitit respektiv paraardhës, të indeksuar me normën e synuar të inflacionit prej 3%.

### **Blerja e humbjeve**

Bazuar në të dhënat e Aplikimit për periudhën 2025 - 2027, për zërin “Blerje për humbjet e energjisë” shoqëria OST sh.a për parashikon si në vijim:

- *Për vitin 2025, humbja e energjisë në rrjet është vlerësuar në rreth 228 GWh. Kjo sasi energjie do të blihet me bazë tregu, duke konsideruar një çmim mesatar vjetor prej rreth 111.8 €/MWh. Fondi që kërkohet për blerjen e kësaj sasive energjie është rreth 25.49 milion euro ose 2,549 milionë lekë.*
- *Për vitin 2026 humbja e energjisë në rrjet është vlerësuar në rreth 234 GWh. Kjo sasi energjie do të blihet me bazë tregu, duke konsideruar një çmim mesatar vjetor prej rreth 101.28 €/MWh. Fondi që kërkohet për blerjen e kësaj sasive energjie është rreth 23.66 milion euro ose 2,366 milionë lekë.*
- *Për vitin 2027 humbja e energjisë në rrjet është vlerësuar në rreth 247 GWh. Kjo sasi energjie do të blihet me bazë tregu, duke konsideruar një çmim mesatar vjetor prej rreth 89.87 €/MWh. Fondi që kërkohet për blerjen e kësaj sasive energjie është rreth 22.22 milion euro ose 2,222 milionë lekë.*

Shoqëria për vitin 2022 deklaroi se, humbjet në rrjetin e transmetimit kanë qenë 200 GWh, duke vijuar me 220 GWh për vitin 2023. Ndërkohë për vitin 2024 parashikon që sasia e humbjeve të jenë 214 GWh. Në lidhje me vlerën monetare të këtij zëri konstatojmë se: stabilizimi dhe ulja e çmimeve të energjisë elektrike për MWh në tregjet ndërkombëtare të energjisë, përgjatë periudhës 2022 – 2024, është reflektuar dhe në një diferencë mes vlerës së


njohur nga ERE për këtë shpenzim për periudhën paraardhëse rregullatore me kostot faktike të këtij zëri (parashikimi 8,794 milion lekë, realizimi 7,179 milion lekë). Këto diferenca vijnë dhe si rezultat i mbulimit të humbjeve të OST sh.a. prej shoqërisë KESH sh.a. me çmimin e blerjes së energjisë nga prodhuesit me përparësi hidrike, gjatë periudhës së gjendjes së emergjencës në furnizim, sipas përcaktimeve të nenit 13, pika 1 e VKM nr.456, datë 29.6.2022 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, efektët e së cilës përfunduan më datë, 31.12.2023, mbështetur në dispozitat e VKM Nr. 449, datë 26.7.2023 “Për një ndryshim në Vendimin nr. 584, datë 8.10.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”, të ndryshuar.

Në lidhje me parashikimin në rritje të sasisë së humbjeve për vitet 2025 – 2027, ERE me shkresën nr. 1859/3 prot., datë 20.09.2024, i kërkoi shoqërisë OST sh.a. ndër të tjera informacion mbi referencat në të cilat ishte mbështetur për kryerjen e parashikimeve për periudhën 2025 - 2027.

Në shkresën nr. 6004/2 prot., datë 07.10.2024, protokolluar me tonën me nr. 1859/4 prot., datë 09.10.2024, OST sh.a. argumenton ndër të tjera se:

*“humbjet e energjisë elektrike në rrjetin transmetimit janë humbje teknike të cilat vijnë si pasojë e humbjeve të fuqisë në elementet e sistemit të transmetimit si linja, transformatorë etj. Referuar vlerave të humbjeve, ekziston një lidhje shumë e fortë ndërmjet prodhimit të energjisë elektrike në Sistemin e Transmetimit dhe humbjeve. Rritja e prodhimit të energjisë elektrike, shoqërohet me rritjen e humbjeve në sistemin e transmetimit dhe anasjelltas.”*

Argumentin e dhënë OST sh.a. e ka shoqëruar me grafikun si më poshtë:



**Burimi: OST sh.a.**

Në lidhje me çmimit e kërkuar për MWh, shoqëria sqaron se i është referuar bursave të energjisë HUPX, HUDEX, HENEX, SEEPX, IBEX, ALPEX, duke analizuar trendin e çmimeve në këto tregje. Kësaj deklarate OST sh.a. nuk i ka bashkëlidhur një referencë konkrete mbi përllogaritjet mbi të cilat është mbështetur në parashikimet e saj.

Vlerësojmë se, në lidhje me çmimin e prokurimit të humbjeve, për secilin vit respektiv pasardhës, në kushtet ku aktualisht Bursa Shqiptare e Energjisë (ALPEX) nuk ofron produkte derivative., të merren si referencë çmimet e publikuara për secilën periudhë respektive nga HUDEX, i cili konsiderohet gjithashtu si një ndër tregjet më përfaqësuese të rajonit.

Me qëllim vijimësinë e ushtrimit të aktivitetit të transmetimit të energjisë elektrike, bazuar në realizimin e këtij zëri si dhe parashikimet e kryera nga shoqëria, vlerësojmë të arsyeshme që për periudhën 2025 – 2027 të merren në konsideratë sasisë e humbjeve të parashikuara nga

OST sh.a sipas çmimeve më të fundit të parashikuar në HUDEX, të cilat evidentohen në tabelën në vijim:

## Daily data

December 13, 2024  [DOWNLOAD AS XLS](#) [DOWNLOAD AS PDF](#)

SHORT TERM WEEK MONTH QUARTER YEAR

### HUDEX HUN Baseload Power - Year Futures

Contract	Contract size (MWh)	Daily best bid (EUR/MWh)	Daily best ask (EUR/MWh)	Best Bid at Market Closure (EUR/MWh)	Best Ask at Market Closure (EUR/MWh)	Number of trades	Exchange volume (MW)	OTC volume (MW)	Last trade price (EUR/MWh)	Settlement price (EUR/MWh)	Relative change (%)	Open interest (MW)
BL YR-25	8760	-	-	-	-	0	0	0	-	105.50	-1.12%	420
BL YR-26	8760	-	-	-	-	0	0	0	-	96.40	-1.49%	40
BL YR-27	8760	-	-	-	-	0	0	0	-	86.78	-0.77%	0
BL YR-28	8784	-	-	-	-	0	0	0	-	-	-	0
BL YR-29	8760	-	-	-	-	0	0	0	-	-	-	0
BL YR-30	8760	-	-	-	-	0	0	0	-	-	-	0

Tabela 17: Tarifa mesatare e transmetimit të energjisë elektrike 2025 - 2027

**Burimi: HUDEX**

Ndërkohë kursi i këmbimit Euro/Lekë i marrë në konsideratë për përllogaritjen e vlerave respektive është mesatarja e kurseve të këmbimit të realizuar gjatë periudhës janar - nëntor 2024 prej 100.93 lekë/euro, të publikuar nga Banka e Shqipërisë sipas tabelës në vijim:

Përshkrimi i treguesit	Jan 2024	Shk 2024	Mar 2024	Pri 2024	Maj 2024	Qer 2024	Korr 2024	Gsh 2024	Sht 2024	Tet 2024	Nën 2024	Mesatarja 11 mujore
E U R O	103.91	103.91	103.57	101.48	100.52	100.35	100.31	99.97	99.35	98.68	98.21	100.93

Në përfundim kosto e humbjeve e përllogaritur për cdo vit të periudhës së ardhshme rregullore evidentohet në tabelën e mësipërme të shpenzimeve operative.

## II. KOSTOT E KAPITALIT (CAPEX)

### RAB (Baza e Rregulluar e Aseteve)

Me anë të shkresës nr.1859/2 prot., datë 20.09.2024, ERE i kërkoi OST sh.a.dërgimin në formë tabelare të listave të asetëve sipas kostos historike (pa përfshirë rivlerësimet), duke evidentuar gjithashtu shtesat përkatëse për çdo grup aseti të realizuara gjatë periudhës rregullore 2022-2024. Gjithashtu, krahas këtyre të dhënave, është kërkuar edhe amortizimi i pritshëm për vitin 2024 dhe paraqitja e parashikimit të Bazës së Rregulluar të Aseteve për periudhën 2025 - 2027. Në përgjigje të sa më sipër, OST sh.a. me anë të shkresës nr. 1859/4 prot., datë 09.10.2024 ndër të tjera përcolli në formatin Excel tabelat dhe listën e asetëve sipas kostos historike si dhe vlerat përkatëse të amortizimit, të cilat paraqiten si më poshtë vijon:

Tabela 9: Baza e rregulluar e asetëve 2022 - 2024

Viti 2022							
Nr	Përshkrimi	Llogaria kontabël	% e amortizimit	Kosto historike e asetëve	Amortizimi vjetor	Amortizimi i akumuluar	Vlera neto e asetëve
1	Software dhe licenca	205/208	15%	1,122,873,291	88,730,769	683,794,281	439,079,009
2	Toka	211	0	856,178,783	-	-	856,178,783
3	Punime në tokë	211.5	5%	705,031,575	15,445,338	116,283,863	588,747,712
4	Ndërtesa	212	5%	2,889,454,498	93,975,925	1,083,757,908	1,805,696,590
5	Instalime dhe makineri	213	5%	25,584,836,717	849,852,344	10,074,217,555	15,510,619,163
6	Linja	213	5%	24,848,706,102	751,061,228	10,163,702,303	14,685,003,798
7	Pajisje, vegla pune	213	20%	2,767,260,973	167,773,807	1,814,367,756	952,893,216
8	Mjete transporti	215	20%	709,503,362	23,799,667	609,085,029	100,418,333
9	Mobileri, pajisje zyre	218.1	20%	201,414,298	9,998,920	102,832,833	98,581,466
10	Pajisje informatike	218.2	25%	1,140,974,733	82,501,541	859,964,979	281,009,754
<b>Total</b>				<b>60,826,234,333</b>	<b>2,083,139,539</b>	<b>25,508,006,507</b>	<b>35,318,227,825</b>

Viti 2023							
Nr	Përshkrimi	Llogaria kontabël	% e amortizimit	Kosto historike e asetëve	Amortizimi vjetor	Amortizimi i akumuluar	Vlera neto e asetëve
1	Software dhe licenca	205/208	15%	1,193,794,328	85,978,652	769,772,934	424,021,394
2	Toka	211	0	856,178,782	-	-	856,178,782
3	Punime në tokë	211.5	5%	705,031,575	14,673,071	130,956,934	574,074,642
4	Ndërtesa	212	5%	2,896,972,026	90,537,015	1,174,294,923	1,722,677,103
5	Instalime dhe makineri	213	5%	25,787,752,815	840,900,016	10,914,410,242	14,873,342,573
6	Linja	213	5%	25,372,603,393	750,900,078	10,914,602,381	14,458,001,012
7	Pajisje të tjera, vegla pune	213	20%	2,851,125,102	147,456,415	1,961,820,228	889,304,875
8	Mjete transporti	215	20%	709,883,362	18,995,268	628,115,869	81,767,493
9	Mobileri, pajisje zyre	218.1	20%	207,165,490	9,394,836	112,219,927	94,945,564
10	Pajisje informatike	218.2	25%	1,196,043,606	65,738,319	925,602,774	270,440,831
<b>Total</b>				<b>61,776,550,481</b>	<b>2,024,573,670</b>	<b>27,531,796,212</b>	<b>34,244,754,269</b>

Viti 2024							
Nr	Përshkrimi	Llogaria kontabël	% e amortizimit	Kosto historike e asetëve	Amortizimi vjetor	Amortizimi i akumuluar	Vlera neto e asetëve
1	Software dhe licenca	205/208	15%	1,193,794,328	85,978,652	855,751,586	338,042,742
2	Toka	211	0	856,178,782	-	-	856,178,782
3	Punime në tokë	211.5	5%	705,031,575	14,673,071	145,630,005	559,401,571
4	Ndërtesa	212	5%	2,896,972,026	90,537,015	1,264,831,938	1,632,140,088
5	Instalime dhe makineri	213	5%	28,721,162,854	975,347,976	11,889,758,218	16,831,404,636
6	Linja	213	5%	29,396,005,571	952,070,187	11,866,672,568	17,529,333,002
7	Pajisje të tjera, vegla pune	213	20%	2,851,125,102	147,456,415	2,109,276,642	741,848,460
8	Mjete transporti	215	20%	753,483,362	26,988,601	655,104,470	98,378,892
9	Mobileri, pajisje zyre	218.1	20%	207,165,490	9,394,836	121,614,762	85,550,728
10	Pajisje informatike	218.2	25%	1,859,756,505	231,666,544	1,157,269,318	702,487,187
<b>Total</b>				<b>69,440,675,597</b>	<b>2,534,113,297</b>	<b>30,065,909,509</b>	<b>39,374,766,088</b>

Burimi: OST sh.a.

Tabela 10: Baza e rregulluar e asetëve 2025 - 2027

Viti 2025							
Nr	Përshkrimi	Llogaria kontabël	% e amortizimit	Kosto historike e asetëve	Amortizimi vjetor	Amortizimi i akumuluar	Vlera neto e asetëve
1	Software dhe licenca	205/208	15%	1,193,794,328	85,978,652	941,730,239	252,064,089
2	Toka	211	0	856,178,782	-	-	856,178,782
3	Punime në tokë	211.5	5%	705,031,575	14,673,071	160,303,076	544,728,500
4	Ndërtesa	212	5%	2,896,972,026	90,537,015	1,355,368,954	1,541,603,073
5	Instalime dhe makineri	213	5%	33,007,148,076	1,007,160,707	12,896,918,925	20,110,229,151
6	Linja	213	5%	33,319,028,740	978,574,242	12,845,246,811	20,473,781,929
7	Pajisje të tjera, vegla pune	213	20%	3,189,740,907	154,228,731	2,263,505,373	926,235,533
8	Mjete transporti	215	20%	753,483,362	26,988,601	682,093,072	71,390,290
9	Mobileri, pajisje zyre	218.1	20%	207,165,490	9,394,836	131,009,598	76,155,892
10	Pajisje informatike	218.2	25%	1,940,765,969	242,805,345	1,400,074,663	540,691,306
<b>Total</b>				<b>78,069,309,255</b>	<b>2,610,341,200</b>	<b>32,676,250,709</b>	<b>45,393,058,546</b>

Viti 2026							
Nr	Përshkrimi	Llogaria kontabël	% e amortizimit	Kosto historike e asetëve	Amortizimi vjetor	Amortizimi i akumuluar	Vlera neto e asetëve
1	Software dhe licenca	205/208	15%	1,193,794,328	85,978,652	1,027,708,891	166,085,437
2	Toka	211	0	856,178,782	-	-	856,178,782
3	Punime në tokë	211.5	5%	705,031,575	14,673,071	174,976,147	530,055,429
4	Ndërtesa	212	5%	2,896,972,026	90,537,015	1,445,905,969	1,451,066,058
5	Instalime dhe makineri	213	5%	33,580,471,776	1,011,699,519	13,908,618,444	19,671,853,332
6	Linja	213	5%	36,310,935,691	1,038,412,381	13,883,659,192	22,427,276,499
7	Pajisje të tjera, vegla pune	213	20%	3,189,740,907	154,228,731	2,417,734,104	772,006,802
8	Mjete transporti	215	20%	753,483,362	26,988,601	709,081,673	44,401,689
9	Mobileri, pajisje zyre	218.1	20%	239,368,330	10,468,264	141,477,862	97,890,468
10	Pajisje informatike	218.2	25%	2,230,591,521	254,881,410	1,654,956,072	575,635,449
<b>Total</b>				<b>81,956,568,298</b>	<b>2,687,867,645</b>	<b>35,364,118,354</b>	<b>46,592,449,945</b>

Viti 2027							
Nr	Përshkrimi	Llogaria kontabël	% e amortizimit	Kosto historike e asetëve	Amortizimi vjetor	Amortizimi i akumuluar	Vlera neto e asetëve
1	Software dhe licenca	205/208	15%	1,193,794,328	85,978,652	1,113,687,543	80,106,785
2	Toka	211	0	856,178,782	-	-	856,178,782
3	Punime në tokë	211.5	5%	705,031,575	14,673,071	189,649,217	515,382,358
4	Ndërtesa	212	5%	2,896,972,026	90,537,015	1,536,442,984	1,360,529,042
5	Instalime dhe makineri	213	5%	33,930,471,776	1,016,074,519	14,924,692,963	19,005,778,812
6	Linja	213	5%	39,276,877,431	1,100,202,834	14,983,862,026	24,293,015,405
7	Pajisje të tjera, vegla pune	213	20%	3,189,740,907	154,228,731	2,571,962,835	617,778,071
8	Mjete transporti	215	20%	753,483,362	26,988,601	736,070,275	17,413,088
9	Mobileri, pajisje zyre	218.1	20%	239,368,330	10,468,264	151,946,125	87,422,204
10	Pajisje informatike	218.2	25%	2,427,600,985	269,757,593	1,924,713,665	502,887,320
<b>Total</b>				<b>85,469,519,502</b>	<b>2,768,909,281</b>	<b>38,133,027,634</b>	<b>47,336,491,868</b>

Burimi: OST sh.a.

Shoqëria ka deklaruar se llogaritja e Asetit Bazë të Rregulluar në fillim të vitit bazë 2025 (Vlera në fund të vitit 2024) është kryer duke marrë për bazë vlerën e RAB të njohur nga ERE në fillim të periudhës rregullatore 2022 – 2024, si dhe duke shtuar mbi këtë vlerë kapitalizimin e të gjitha investimeve në proces, të kryera gjatë periudhës 2022 - 2024. Më tej, vlerës rezultuese i është zbritur amortizimi përkatës i kësaj periudhe. Sikurse në Aplikim, ashtu edhe në shkresën nr. 6004/2 prot., datë 07.10.2024, protokolluar me tonën me nr. 1859/4 prot., datë 09.10.2024, OST sh.a. deklaroi se për vitin 2024 pret të kapitalizojë 7,664 milion lekë të kontratave të investimeve në proces.

Referuar “Planit të Investimeve për periudhën 2022 – 2024 dhe 2025 – 2027”, të cilin shoqëria ja ka bashkëlidhur Aplikimit për tarifën e transmetimit për periudhën rregullatore 2025 – 2027”, në tabelën e realizimit të investimeve për periudhën 2022 – 2024, konstatohet se totali i kontratave që priten të kapitalizohen deri në fund të vitit 2024 është në vlerën 3,640 milion lekë. Kjo vlerë është marre në konsideratë në vlerësimet tona për përlllogaritjen e RAB për vitin 2024.

Bazuar në “Rregulloren për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 135, datë 06.09.2017, neni 11, përcaktohen afatet për paraqitjen dhe miratimin e planit të investimeve në kontekstin e aplikimit dhe miratimit të tarifave për veprimtaritë e ushtruara nga operatorët e transmetimit dhe të shpërndarjes në tregun e energjisë elektrike. Këta të fundit do të paraqesin në ERE planin e investimeve për vitin pasardhës në të njëjtën kohë me aplikimin për tarifë.

Në përputhje me dispozitën e mësipërme, ERE me shkresën nr.1859/2 prot., datë 20.09.2024, ka kërkuar ndaj shoqërisë OST sh.a., depozitimin e planit të investimeve si një kërkesë më vete nga aplikimi për tarifë, shqyrtimi i së cilës do të kryhej paralelisht me procesin e përcaktimit të tarifës për periudhën rregullatore 2025 – 2027.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, OST sh.a. me shkresën nr. 6943 prot., datë 10.10.2024, (protokolluar me tonën me nr. 2098 prot., datë 11.10.2024), OST sh.a. ka paraqitur kërkesën për miratimin e “Planit të investimeve të OST sh.a. për periudhën rregullatore 2025 – 2027”. Pasi dokumentacioni i paraqitur u shqyrtua në përputhje me kërkesat e “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 135, datë 06.09.2017, bordi i ERE-s me vendimin nr. 247, datë 18.11.2024, vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin e Planit të investimeve për periudhën rregullatore 2025 – 2027.

Në rrethanat, ku procedura për miratimin e “Planit të investimeve për periudhën rregullatore 2025 – 2027” gjendet ende në proces, konsiderojmë se investimet të cilat mund të pranohen në bazën e rregulluar të aseteve për periudhën 2025 - 2027 të jenë vlerat e investimeve të paraqitura në dokumentin e sipërcituar, për të cilin ERE pritet të dalë me një vendim.

Vlera e investimeve sipas natyrës së projekteve të parashikura në planin e investimeve për periudhën rregullatore 2025-2027 paraqitet në vijim:

Tabela 11: Vlera e investimeve të parashikuara sipas natyrës së projekteve 2025 - 2027

(Vlera në milionë lekë)	2025	2026	2027	2025-2027
<b>Nënstacione</b>	4,246.0	779.3	350.0	5,375.2
<b>Linja 220 kv dhe 400 kv</b>	2,439.2	674.3	536.4	3,649.8
<b>Linja 110 kv</b>	1,862.5	2,111.7	2,429.5	6,403.8
<b>IT; Cyber;Telekomunikacion</b>	81.0	322.0	197.0	600.0
<b>Te tjera</b>	-	-	-	-
<b>Totali</b>	<b>8,628.6</b>	<b>3,887.3</b>	<b>3,513.0</b>	<b>16,028.8</b>

**Burimi: OST sh.a.**

Në zbatim të nenit 7, pika 4.2.6. të Metodologjisë përkatëse, në bazën e rregulluar të aseteve mund të përfshihen vetëm investime në nivele të kujdesshme, të aprovuara nga ERE. Në kuptim të sa më sipër, në rast se “Plani i investimeve për periudhën rregullatore 2025 – 2027” i miratuar nga ERE do tëë ketë ndryshime nga sa propozuar nga shoqëria OST sh.a, ERE do të konsiderojë rishikimin e CAPEX lidhur me investimet që priten të realizohen nga OST sh.a, në periudhën pasardhëse.

Gjithashtu, ERE konform dispozitave të “Metodologjisë së llogaritjes së Tarifës së Transmetimit” do të aplikojë korigjimet përkatëse bazuar në realizimin faktik të tyre gjatë periudhës në fjalë, si dhe duke njohur vlerën e aseteve, të cilat janë futur në operim për çdo vit, sikurse vepruar dhe në procedurat e mëparshme rregullatore.

Duke konsideruar gjithë komponentët sa më sipër, paraqesim në vijim bazën e rregulluar të aseteve të OST sh.a. për periudhën parardhëse rregullatore 2022 – 2024, si dhe parashikimin e saj për periudhën rregullatore 2025 – 2027 të përllogaritur e pranuar nga ERE krahas bazës së rregulluar të aseteve të paraqitur nga OST sh.a. në këtë aplikim:

Tabela 12: Baza e rregulluar e asetëve për periudhën 2025 – 2027

Zeri	Aplikimi i OST							Pranimet e ERE						
	Realizuar nga OST 2022	Realizuar nga OST 2023	Realizuar nga OST 2024	Mesatare 3 vjeçare	Parashikim 2025	Parashikim 2026	Parashikim 2027	Mesatare 3 vjeçare	Pranimet e ERE mbi realizimin 2022	Pranimet e ERE mbi realizimin 2023	Pranimet e ERE për 2024	Parashikim 2025	Parashikim 2026	Parashikim 2027
Vlera e asetëve deri në fund të vitit 2021									63,197	63,197	63,197	63,197	63,197	63,197
Vlera e investimeve të parashikuara 2022 (1/2)									1,698	1,698	1,698	1,698	1,698	1,698
Vlera e investimeve të parashikuara 2023 (1/2)										880	880	880	880	880
Vlera e investimeve të parashikuara 2024 (1/2)											1,820	3,640	3,640	3,640
Vlera e investimeve të parashikuara 2025 (1/2)												4,314	8,629	8,629
Vlera e investimeve të parashikuara 2026 (1/2)													1,943	3,887
Vlera e investimeve të parashikuara 2027 (1/2)														1,757
Amortizimi i pritshëm 2022									(2,083)					
Amortizimi i pritshëm 2023										(2,024)				
Amortizimi i pritshëm 2024											(2,534)			
Amortizimi i pritshëm 2025												(2,610)		
Amortizimi i pritshëm 2026													(2,688)	
Amortizimi i pritshëm 2027														(2,769)
Grante									(1,156)	(1,180)	(1,158)	(1,165)	(1,165)	(1,165)
<b>Vlera Neto e Asetëve</b>	<b>33,029</b>	<b>33,900</b>	<b>39,031</b>	<b>35,320</b>	<b>45,050</b>	<b>46,249</b>	<b>46,993</b>	<b>46,097</b>	<b>35,601</b>	<b>34,433</b>	<b>33,741</b>	<b>37,258</b>	<b>40,828</b>	<b>41,780</b>

Burimi: ERE

### Amortizimi

Në lidhje me zërin “Amortizimi”, shoqëria ka parashikuar se për vitin 2024 do të jetë në vlerën 2,534 milion lekë. Më tej për periudhën rregullatore, kostot e parashikuara nga OST sh.a. për këtë zë janë 2,610 milion lekë për 2025, duke vijuar me 2,688 milion lekë për 2026 si dhe 2,769 për 2027. Këto vlera janë konsideruar gjithashtu në vlerësimin tonë, pasi mbështeten mbi kostot historike të asetëve si dhe investimeve në proces që pritet të kapitalizohen gjatë kësaj periudhe rregullatore.

Vlera e amortizimit për periudhën rregullatore 2025-2027 konsideron dhe amortizimin e shtesave të reja të parashikuara për periudhën 2025 - 2027. Sikurse sqaruar dhe më lart, theksojmë se vlera e investimeve që pritet të kapitalizohen për këtë periudhë, të përfshira në bazën e rregulluar të asetëve, mund të pësojë ndryshime. Në lidhje me këtë aspekt, konsiderojmë se nëse rezulton një diferencë më e madhe nga pranimi i ERE, kjo vlerë do të mbetet si gjendje likuiditeti për mbulimin e kredive të marra për qëllime të kryerjes së investimeve. Mbështetur në parashikimet e Metodologjisë së tarifave të operatorit të sistemit të transmetimit, në rastin e realizimit të diferencave mbi/nën vlerat e konsideruara, amortizimi do të korigjohet në periudhën pasardhëse, sikurse parashikuar dhe për vlerën e asetëve, të cilat do të hyjnë në operim.

### Kosto mesatare e ponderuar e kapitalit (WACC)

Referuar Aplikimit të shoqërisë për periudhën 2025-2027, në përllogaritjet e kryera OST sh.a. ka konsideruar objektivin për raportin e kapitalit të vet **ES= 72.9%**.

OST sh.a ka paraqitur në përllogaritjen e tarifës së transmetimit për periudhën rregullatore 2025–2027, përpos normës së lejuar të kthimit të kapitalit të miratuar nga ERE me vendimin e bordit nr. 72/2022, ku **AroE=2.28%**, edhe një variant të dytë të normës së kthimit të kapitalit **AroE=4.81%**. Norma mesatare e interesit mbi borxhin afatgjatë e përllogaritur nga shoqëria është **CoD=2.71%** për të gjithë periudhën rregullatore. Lidhur me sa më sipër, në korrespondencat e zhvilluara në kuadër të këtij aplikimi, si dhe gjatë seancës teknike, OST sh.a. ju kërkuan referencat mbi të cilat është mbështetur për propozimin e normës AroE në këtë masë. Në përgjigjen nr. 6004/7 prot., datë 02.12.2024, protokolluar me tonën me nr. 1859/19 prot., datë 03.12.2024, OST sh.a. ka sqaruar se është mbështetur mbi treguesit faktik financiar të vitit ushtrimor të mbyllur 2023.

Në vlerësimin tonë, për përlogaritjen e kostos mesatare të ponderuar të kapitalit të shoqërisë OST sh.a., për periudhëm 2025 – 2027, jemi mbështetur në strukturën e kapitalit dhe të borxhit afatgjatë, të realizuar nga OST sh.a. gjatë viteve 2022 dhe 2023 si dhe mbi raportet e pritshme të këtyre treguesve për vitin 2024, e cila rezulton ES=47.84 % dhe DS=52.16%.

Në lidhje me normën e lejuar mesatare të kthimit të kapitalit (AroE) të shoqërisë OST sh.a., për periudhën 2025 – 2027, konform parashikimeve të “Metodologjisë së përcaktimit të tarifave të transmetimit”, është konsideruar si e njaftueshme norma e kthimit të ankandit të fundit të bonove të thesarit, të publikuar nga Banka e Shqipërisë, ku AROE=2.86 %.

### Rezultatet e ankandeve të zhvilluara

Më poshtë jepen rezultatet e tre ankandeve të fundit të bonove të thesarit.

ISIN: AL000A3L49H4		Nr. ankandit: 2049	
Dt. e ankandit:		12.11.2024	
Dt. e emetimit:		14.11.2024	
Dt. e maturimit:		13.11.2025	
Nr. muajve:		12 (Muaj)	
Shuma e shpallur:		7,500,000,000 (ALL)	
Nga kjo i takon Bankës së Shqipërisë:		1,600,000,000 (ALL)	
		Kërkuar	Pranuar
Nr. i kërkesave konkurruese		14	12
Totali (ALL)		8,932,420,000	7,499,990,000
Yield-i mesatar i ponderuar		2.86 %	2.84 %
Yield-i maksimal		3.01 %	2.90 %
Yield-i minimal		2.77 %	2.77 %
Yield-i mesatar i thjeshtë		2.87 %	2.86 %

**Burimi: Banka e Shqipërisë**

Nga shqyrtimi i pasqyrave financiare të vitit 2022 - 2023 si dhe të dhënave të dërguara për vitin 2024 nga OST në kuadër të këtij procesi, gjendja e huave rezulton si vijon:

Viti	Kredi afatgjata (mil/lekë)	Interesa te paguar (mil/lekë)	Kosto e borxhit
2022	28,561	447	1.57%
2023	25,042	414	1.65%
<b>Parashikim 2024</b>	21,225	364	<b>1.71%</b>

Në tabelën në vijim paraqiten shpenzimet për interesa, të cilat OST sh.a. parashikon të shlyejë gjatë periudhës 2025-2027:

Tabela 13: Huatë afatgjata për periudhën 2025 - 2027

Marre nga	Projekti	Banka/ Kreditori	Monedha	INTERESA NE LEK 2025	INTERESA NE LEK 2026	INTERESA NE LEK 2027
	JBIC Rehabilitimi i Hece-ve te kaskades se Dritit. Per OST N/st. Fierze & V.Dejes (ABA P1)	JBIC	YEN	215,045.11	-	-
	World Bank ( Nr.36710 ALB ) (Gov.AL)	Banka Botërore	USD	-	-	-
	World Bank ( Nr.38720 ALB ) (Gov.AL)	Banka Botërore	USD	2,414,036.38	-	-
	E.B.R.D. ( Nr.23830 )	EBRD	EUR	-	-	-
	E.B.R.D. ( Nr.33833 )	EBRD	EUR	-	2,675,252.73	-
	E.B.R.D. ( Nr.36112 )	EBRD	EUR	-	-	-
<b>KESH</b>	Swiss Grant (Gov.AL) SECO	Qeveria Zviceriane SEC	CHF	-	-	-
	Swiss Grant (Gov.AL) SECO	Qeveria Zviceriane SEC	USD	-	-	-
	European Investment Bank ( Nr.21264 )	EIB	EUR	-	-	-
	EIB - Vlora Thermo Power Plant (Nr.22706)	EIB	EUR	-	-	-
	J.B.I.C-Japan (ABA-P2)	JBIC	YEN	316,993.93	316,993.93	-
